
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

31.07.2025

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “Porsche Albania” shpk, me NUIS: **K51914014P**, me adresë:
TIRANE AUT. TIRANE-DURRES KM 3-MEZEZ.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra- Kontratë.

Referenca e Lotit: REF-51861-06-19-2025.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje automjete për Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”, me fond limit: 16,658,633 (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, me afat zbatimi brenda 3 (tre) muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 20.06.2025.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 32 datë 23 Qeshor 2025.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. “Porsche Albania” SH.P.K

K51914014P

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 14,680,000 (katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “Mektrin Motors” SH.P.K

L71607505F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 15,560,000 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “Delfino Albania” SH.P.K

M22420009S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 15,825,701 (pesëmbëdhjetë milion tetëqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e një) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “Albania Motor Company” SH.P.K

K41829010I

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 15,960,000 (pesëmbëdhjetë milion e nënëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. "C L A S S I C" SH.P.K

J91909004J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 16,400,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "Mektrin Motors" SH.P.K

L71607505F

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera: 15,560,000 (pesëmbëdhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2, pasi Autorizimi i paraqitur për "Mektrin Motors sh.p.k." është lëshuar nga kompania KMAG d.o.o., një shoqëri e regjistruar në Mal të Zi. Në autorizim pretendohet se KMAG është distributor zyrtar për tregun shqiptar, por:

- LOI (Letter of Intent) lëshuar nga KG Mobility (KGM), Kore e Jugut për KMAG d.o.o. me seli në Kroaci, e kufizon qartë veprimtarinë vetëm për territorin e Shqipërisë dhe Kroacisë.
- KMAG Mal i Zi nuk ka një dokument të drejtpërdrejtë nga prodhuesi që e autorizon për tregun shqiptar.
- Nuk ka dokument mbështetës që provon se KMAG Mali i Zi është i autorizuar nga KMAG Kroaci, as ndonjë deklaratë ndërmjet palëve që e justifikon delegimin territorial të kompetencës. Prandaj, autorizimi i paraqitur për "Mektrin Motors" është fiktiv dhe i pabazuar në një zinxhir te

vlefshem të autorizimeve nga prodhuesi, duke bërë që ky operator të mos përmbushë pikën 2 të kriterëve të kualifikimit.

Nuk përmbush kriteret e vecanta të kualifikimit, pikën 5, pasi pas verifikimit të Katalogut të Prodhuesit të paraqitur nga operatori ekonomik, u konstatua se:

- Nuk është e dokumentuar përmbushja e kërkesës për shtrojat e këmbëve (tapetet), të cilat sipas specifikimeve teknike duhet të jenë prej materiali gome. Katalogu i paraqitur përmend vetëm ekzistencën e tapeteve, por nuk përcakton materialin.
- Nuk është e dokumentuar ofrimi i pajisjeve të emergjencës: trekëndëshi i rrezikut dhe kutia e ndihmës së shpejtë, të cilat janë pjesë e detyrueshme të specifikimeve teknike në Shtojcën 6. Për rrjedhojë, oferta nuk plotëson kriteret e kërkuara teknike dhe skualifikohet në këtë fazë të vlerësimit.

Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, pikën 6 pasi operatori ekonomik ka paraqitur deklaratë se mjetet janë prodhuar në BE dhe për në BE, por Deklarata e Konformitetit duket se nënshkrimi në këtë deklaratë është marrë kopë nga një dokument tjetër dhe nuk ka nënshkrim origjinal mbi këtë dokument.

- Dokumenti i paraqitur nuk ka një firmë origjinale mbi të;
- Nënshkrimi duket të jetë marrë si “copy-paste” nga një dokument tjetër, duke ngritur dyshime serioze mbi vlefshmërinë, autenticitetin dhe origjinalitetin e këtij akti.

1. Mjeti është prodhuar nga një kompani koreane (KG Mobility – ish SsangYong), por jo për tregun e BE-së

- Në Certifikatën e Konformitetit thuhet qartë:

"Place: Pyeongtaek-si, Korea", dhe data e prodhimit është 16.10.2024;

- Prodhimi është kryer në Korenë e Jugut, dhe nuk ka dëshmi që automjeti është importuar apo prodhuar për tregun e BE-së nga ndonjë përfaqësues zyrtar evropian.

2. Dokumenti është lëshuar nga KG Mobility Korea, jo nga një përfaqësues i autorizuar për BE-në

- Vetë prodhuesi është koreano-jugor, me adresë në Kore:

“455-12, Dongsak-ro, Pyeongtaek-si, Gyeonggi-do, Korea”

- Në pikën 0.9 përfaqësuesi evropian përmendet vetëm si "KG Mobility Europe Parts Center B.V.", me adresë në Breda, Holandë, por:

- Nuk ka nënshkrim apo firmë të këtij përfaqësuesi;

- Nuk është e qartë nëse ky përfaqësues ka të drejtë të lëshojë certifikata për mjetet e importuara në BE ose për Shqipëri.

3. Certifikata e Konformitetit nuk përmban elementë të gjurmueshëm të zbatimit në BE

- Asnjë prej këtyre nuk ndodhet në certifikatë:

- Asnjë VIN number i regjistruar në sistemet e BE-së (EUCARIS, WVTA, apo RMI);

- Asnjë reference të importit në BE;

- Asnjë targë prove BE-je ose vend prodhimi në BE;

•Asnjë firmë ose vulë të një importuesi zyrtar në BE (shumë i rëndësishëm për vërtetimin e përputhshmërisë me direktivat e BE-së për automjetet e kategorisë M1).

4. Nuk ka asnjë lidhje ligjore të dokumentit me autoritetin kontraktor shqiptar

•Dokumenti është i përgjithshëm, jo i adresuar:

•As AK-së shqiptare,

•As objektit të prokurimit,

•As referencës së tenderit.

•Prandaj, nuk përmbush as elementet formale të një deklarate për tender publik, dhe nuk garanton asgjë për origjinën apo destinacionin e mjetit.

Përfundimisht:

a)Ky dokument nuk vërteton që automjeti është prodhuar për tregun e BE-së.

b)Nuk vërteton as përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit që kërkon origjinë BE-je dhe deklarata nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij zyrtar.

c)Dokumenti është i përgjithshëm dhe nuk ka lidhje as me tenderin, as me Shqipërinë, as me kërkesën ligjore të dokumentacionit të tenderit.

Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 7, pasi deklarata e dhene nga operatori ekonomik Deklarata e dorëzuar nga operatori është e painedividualizuar, e përgjithshme dhe nuk përmban asnjë informacion që e lidh me procedurën konkrete të prokurimit, si:

•Emri i autoritetit kontraktor;

•Numri i referencës së procedurës;

•Objekti i kontratës publike;

•Loti i tenderit (nëse ka).

Kjo përbën shkelje të formës dhe përmbajtjes së kërkuar, duke mos garantuar që dokumenti i referohet realisht kësaj procedure.

2. “Delfino Albania” SH.P.K

Emri i plotë i shoqërisë

M22420009S

Numri i NIPT-it

Vlera: 15,825,701 (pesëmbëdhjetë milion tetëqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e një) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “Delfino Albania” sh.p.k nuk ka deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të ciles/cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetdeklarimeve, në Pjesën II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, në Formularin e Përmbledhës të Vetdeklarimit, për Seksionet si në vijim:

•Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Vendimin Nr.816/2025, date 27.06.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.

Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 1, shkronjen b) pasi sigurimi I ofertes eshte prere per nje autoritet tjeter kontraktor dhe jo per autoritetin tone kontraktor OBP qe zhvillon procedure e prokurimit.

Nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 2.3, nënpika 1, shkronjat a) dhe b), pasi faturat tatimore të shitblerjes të paraqitura në Sistem Prokurimi Elektronik (SPE) kanë vlerë zero (0), si dhe nuk janë lëshuar brenda periudhës së kërkuar prej 3 (tre) viteve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, që është 20.06.2025. Këto fatura janë lëshuar në datën 08.07.2025, pra pas publikimit të procedurës së prokurimit në SPE.

Nuk permbush kriterin e vecante te kualifikimit, piken 2, pasi Autorizimi i paraqitur për "Delfino Albania" sh.p.k. është lëshuar nga kompania VCAG d.o.o., një shoqëri e regjistruar në Kroaci. Në autorizim pretendohet se VCAG është distributor zyrtar për tregun shqiptar, por: VCAG Kroaci, nuk ka një dokument të drejtpërdrejtë nga prodhuesi I mjeteve që e autorizon për tregun shqiptar. Nuk ka dokument mbështetës që provon se VCAG Kroaci është i autorizuar nga kompania Kineze e mjeteve GEELY, as ndonjë deklaratë ndërmjet palëve që e justifikon delegimin territorial të kompetencës. Prandaj, autorizimi i paraqitur për " VCAG Kroaci" është fiktiv dhe i pabazuar në një zinxhir te vlefshem të autorizimeve nga prodhuesi, duke bërë që ky operator të mos përmbushë pikën 2 të kriterëve të kualifikimit.

Operatori ekonomik **“Besnik Meci” P.F** nuk ka deklaruar adresen apo dokumentin konkret mbi bazen e te ciles/cilit autoriteti mund te beje verifikimin e vetdeklarimeve, ne Pjesen II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ne Formularin e Permbledhes te Vetdeklarimit, per Seksionet si ne vijim:

•Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

- Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
- Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
- Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
- Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
- Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
- Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
- Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
- Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____
- Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

KVO konstaton qe operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Vendimin Nr.816/2025, date 27.06.2025. Per sa me siper operatori ekonomik skualifikohet.

3. “Albania Motor Company” SH.P.K
Emri i plotë i shoqërisë

K41829010I
Numri i NIPT-it

Vlera: 15,960,000 (pesëmbëdhjetë milion e nënëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik nuk ka deklaruar adresën apo dokumentin konkret mbi bazën e të ciles/cilit autoriteti mund të bëjë verifikimin e vetdeklarimeve, në Pjesën II: Shkaqet e përjashtimit A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, në Formularin e Permblidhjes të Vetdeklarimit, për Seksionet si në vijim:

•Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontratë koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

•Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

KVO konstaton që operatori ekonomik nuk ka paraqitur të dhëna dhe dokumenta referues për plotësimin e të gjitha rubrikave të mësipërme për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit. Qendrim ky i mbajtur dhe nga Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Vendimin Nr.816/2025, datë 27.06.2025. Për sa me sipër operatori ekonomik skualifikohet.

Operatori ekonomik Albania Motor Company nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 2, pasi nuk ka paraqitur një autorizim të vlefshëm nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar.

Dokumenti i vetmi që është paraqitur si autorizim është një letër konfirmimi e datës 20.10.2023 nga kompania Grand Automotive Adriatic d.o.o., e cila deklaron se Albania Motor Company është përfaqësues i autorizuar i markës MG Motor. Megjithatë:

- Autorizimi nuk është shoqëruar me dokument vërtetues që tregon se vetë Grand Automotive është distributor i autorizuar nga prodhuesi (SAIC Motor), ashtu siç kërkohet nga dokumentet e tenderit.

- Autorizimi nuk përmban të dhënat e kontaktit të prodhuesit (tel, fax, email, website), të cilat ishin kërkesë e shprehur dhe e detyrueshme në DST, me qëllim mundësimin e verifikimit nga Autoriteti Kontraktor.

- Gjithashtu, operatori ka paraqitur një vetëdeklarim teknik, i hartuar nga vetë kompania, pa mbështetje apo miratim nga distributori ose prodhuesi.

Bazuar në sa më sipër, operatori nuk përmbush kriterin e kualifikimit të përcaktuar në pikën 2 të specifikimeve të tenderit, dhe si rrjedhojë, skualifikohet nga procedura e prokurimit.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatori ekonomik për automjetin Geely Coolray GF AT 1.5 Turbo 172 hp, u konstatua se ky automjet nuk përmbush disa nga kriteret e detyrueshme të specifikuara në Formularin e Specifikimeve Teknike (Shtojca 6), të hartuara nga autoriteti kontraktor. Në përputhje me kërkesën e qartë se çdo specifikim teknik duhet të përmbushet 100%, në të kundërt përbën kusht për skualifikim, konstatohet si më poshtë:

1. Numri i cilindrave të motorit:

o Në specifikimet teknike të kërkuara përcaktohet se motori duhet të ketë jo më pak se 4 (katër) cilindra.

o Në dokumentacionin e paraqitur nga operatori rezulton se automjeti Geely Coolray është i pajisur me motor me 3 cilindra, gjë që bie ndesh me kriterin e detyrueshëm teknik.

2. Pajisje të detyrueshme të sigurisë dhe përdorimit:

o Nuk është provuar përmbushja e kërkesave për:

- Kit riparimi (ose gomë rezervë),
- Trekëndësh sigurie,
- Kuti e ndihmës së shpejtë,
- Drita mjegulle përpara,
- Tapete gome për këmbët.

o Në mungesë të informacionit të qartë dhe të dokumentuar për këto pajisje, konsiderohet se kriteret nuk janë përmbushur.

Për sa më sipër, bazuar në nenin përkatës të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe në zbatim të dokumentacionit të tenderit të publikuar nga autoriteti kontraktor, oferta e paraqitur nga operatori ekonomik nuk përmbush plotësisht kërkesat teknike dhe për këtë arsye skualifikohet nga procedura e prokurimit.

Operatori ekonomik Albania Motor Company nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, pika 5, të përcaktuar në Dokumentat Standarde të Tenderit (DST), i cili kërkon:

"Paraqitjen e katalogut ose skedës teknike nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar, ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së."

Në vend të dokumentacionit të kërkuar, operatori ka paraqitur një dokument me të dhëna teknike të hartuara nga vetë subjekti ofertues, pa ndonjë katalog apo skedë teknike zyrtare të lëshuar nga prodhuesi ose nga një distributor i autorizuar.

Ky dokument:

- Nuk përbën provë autentike për karakteristikat teknike të mjetit të ofruar;
- Nuk ka burim zyrtar, gjë që e bën të pamundur verifikimin dhe krahasimin objektiv të përputhshmërisë me kërkesat teknike të tenderit;
- Nuk përmban referenca, logo apo prova që të vërtetojnë se është dokument zyrtar i prodhuesit apo i një distributori të autorizuar.

Edhe nëse do të merrej në konsideratë ky dokument (gjë që në vetvete është e papranueshme në kushtet e mësipërme), operatori serish nuk paraqet një autorizim të vlefshëm sipas kërkesave të pikës 2 të kritereve të veçanta të kualifikimit.

Konkretisht:

- Operatorit i mungon një autorizim direkt nga prodhuesi;
- Gjithashtu, nuk ka paraqitur asnjë dokument që të provojë se subjekti që ka lëshuar autorizimin (Grand Automotive Adriatic) është vetë i autorizuar nga prodhuesi për rajonin;
- Autorizimi i paraqitur nuk përmban të dhënat e nevojshme të prodhuesit (tel., email, fax, website), siç kërkohet shprehimisht për qëllime verifikimi nga autoriteti kontraktor.

Për të gjitha këto arsye, operatori nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat 2 dhe 5 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, dhe si rrjedhojë skualifikohet nga procedura e prokurimit.

Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin specifik të pikës 6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, sipas të cilit: “Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE, dhe për këtë duhet të paraqesë deklaratën e shoqëruar me certifikatën e konformitetit (CoC) ose ekuivalentin e saj.”

Në rastin konkret: Operatori ekonomik ka paraqitur vetëm një deklaratë, të nënshkruar nga vetë ai (Albania Motor Company), ku thuhet se “mjetet janë të prodhuara për përdorim në BE”, dhe se “me dorëzimin e mjetit do të shoqërohet edhe certifikata CoC”.

Përveç kësaj deklarate, është bashkëngjitur një dokument i titulluar “Draft Certificate of Conformity – e lëshuar nga SAIC Motor Corporation Limited, prodhues i autorizuar kinez, dhe përfaqësuar nga SAIC Motor Europe B.V., me adresë në Holandë, që evidenton lidhjen me tregun europian. Certifikata përmban referenca të rregullores së BE-së (EU) 2018/858 (këto janë në përputhje me homologimin tip të Bashkimit Europian – ECWVTA), duke konfirmuar potencialisht përmbushjen e kërkesave ligjore për tregun europian.

Megjithatë, certifikata është e lidhur me një mjet specifik me numër shasie LSJA24398PN157545 dhe vit prodhimi 2023, ndonëse në dokumentacionin e tenderit kërkohet që mjetet të jenë prodhuar me vit prodhimi ≥ 2024 .

Viti i prodhimit është element kyç dhe i papërshtatshëm në këtë rast, pasi garancia për përputhshmërinë teknike dhe ligjore të mjetit lidhet drejtpërdrejt me këtë parametrin, dhe nuk mund të pranohet asnjë mjet me vit prodhimi më të ulët se ai i kërkuar. Çdo devijim nga ky kriter krijon dyshime serioze mbi përputhshmërinë e mjetit me specifikimet e tenderit dhe standardet e kërkuara.

Dokumenti është një draft dhe nuk përmban elementë që konfirmojnë vlefshmërinë për modelin konkret që ofrohet në tender, ashtu siç kërkohet për të garantuar përputhshmërinë dhe ligjshmerinë e produktit.

Sipas Neni 36 i Regullorjes (EU) 2018/858, certifikata e konformitetit (CoC) duhet të lëshohet nga prodhuesi i autorizuar për çdo njësi individuale, vetëm pasi ai ka marrë homologimin tip të BE-së (ECWVTA), duke vërtetuar që mjeti është prodhuar për tregun e Bashkimit Europian dhe është në përputhje me standardet e BE-së.

Në këtë rast mungojnë dëshmitë që certifikata e paraqitur është e vlefshme për mjetin konkret dhe se ky mjet potencial është prodhuar për tregun europian sipas kërkesave ligjore.

Për këto arsye, operatori ekonomik nuk përmbush kushtet e pikës 6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur një certifikatë konformiteti të vlefshme dhe të plotë, që të garantojë prodhimin e mjetit me vit prodhimi ≥ 2024 dhe destinimin e tij për tregun e Bashkimit Europian.

4. “C L A S S I C” SH.P.K

Emri i plotë i shoqërisë

J91909004J

Numri i NIPT-it

Vlera: 16,400,000 (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 1, shkronjen b) pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes.

Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 4, pasi operatori ka deshtuar të paraqesë në SPE ISO 9001:2015.

Nuk përmbush kriterin e vecante të kualifikimit, piken 7, pasi deklarata e dhënë nga operatori ekonomik Deklarata e dorëzuar nga operatori është e paimpaktshme dhe nuk përmban asnjë informacion që e lidh me procedurën konkrete të prokurimit, si:

- Emri i autoritetit kontraktor;
- Numri i referencës së procedurës;
- Objekti i kontratës publike;
- Loti i tenderit (nëse ka).

Kjo përbën shkelje të formës dhe përmbajtjes së kërkuar, duke mos garantuar që dokumenti i referohet realisht kësaj procedure.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “**Porsche Albania**” shpk, me adresë: “TIRANE AUT. TIRANE-DURRES KM 3-MEZEZ.”, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 14,680,000 (katërmëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR